



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 2996/2 Prishtinë 28.09. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Florentinë Latifi ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Sjellja e strukturave nga betony I armuar me etazhitet të mesëm nga veprimi I ndikimeve sizmike dhe analiza e sanimeve të tyre** ” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Mënyra se si reagojnë strukturat nën veprimin e forcës sizmike varet nga shumë faktor të cilët përveç që ndërlidhen me natyrën e lëkundjeve të tokës, varen edhe nga karakteristikat e vetë trullit në të cilin është i funduar objekti, pastaj nga karakteristikat e vetë objektit, duke përfshirë këtu sistemin strukturor mbajtës, efektin e konfiguracionit (forma, madhësia, lartësia), materialet e përdorura, teknologjinë e ndërtimit, vjetërsia e strukturës, mirëmbajtja e saj, e më shumë.

Për të bërë vlerësimin e reagimit të një strukture nga betoni i armuar ndaj veprimit të tërmetit, rëndësi të madhe ka njohja e formave më të shpeshta të dëmtimeve që paraqiten në elementet e strukturës.

Elementet më të ndjeshme nga veprimi i ndikimeve sizmike e që duhet të analizohet sjellja e tyre dhe forma e paraqitjes së dëmtimeve janë: shtyllat, muret mbajtëse, lidhjet tra-shtyllë si elementet më të rrezikuara që duhet trajtohen me kujdes të veçantë, trajet, pllakat si dhe reagimi i elementeve jostrukturore, veçanërisht reagimi i muraturës mbushëse.

Parametrat kryesorë që ndikojnë në reagimin sizmik të strukturave janë: shtangësia, rezistenca (aftësia mbajtëse) dhe duktiliteti. Pas vlerësimit të gjendjes së strukturës, duhet të bëhet përzgjedhja e skemës për sanim, e që është në funksion se cilët nga parametrat e lartcekur janë cënuar nga dëmtimi i strukturës.

Rast studimor për këtë punim diplome është reagimi i strukturave me etazhitet të mesëm nga betoni i armuar, pas veprimit të tërmetit në Durrës (Shqipëri), më 26 nëntor 2019. Të dhëna lidhur me sizmicitetin e rajonit, regjistrimet mbi tërmetin, efektet gjeoteknike, për tipologjitë e ndërtimit e kodet e projektimit antisizmik, fazat e inspektimeve të strukturave; në përgjithësi format më të shpeshta të paraqitura të dëmtimeve, e në veçanti reagimi i strukturave të ndërtuara në periudhat e viteve 1980, 2000 dhe pas 2010tës. Më pas është analizuar dhe projektuar përforcimi me fibra polimere FRP i një elementi (shtyllë) nga betoni i armuar, të një objekti sipas standardit amerikan për projektimin e përforcimit të strukturave me FRP – ACI 440.2R-08.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.